

KONTRATË PËR SHITBLERJEN E KUOTAVE

ndërmjet

Endri Gjokrushi

dhe

MC Investment Group SHPK

DATË

01.03.2023

Sot më 01.03.2023, në Tiranë , palët e mëposhtme:

1. **Endri Gjokrushi** lindur më 25.06.1984, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shtetas Shqiptar, me numër personal I40625024R

madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

(këtej e tutje do të quhet “**Shitësi**”);

DHE

2. **MC Investment Group**, një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës bazohet në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIP/T L41909013F dhe seli Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati 8, Hyrja Tirane, e perfaqesa nga administratori i saj Z.Eduard Hyseni, lindur më 05.07.1966, në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Shtetas Shqiptar, me numër personal G60705042K, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

(këtej e tutje do të quhet “**Blerësi**”);

Duke qenë se:

1. **Endri Gjokrushi** zotëron 55% të kuotave të shoqërisë “JOMART sh.p.k”, një shoqëri e së drejtës shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës bazohet në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIP/T M31413010J dhe seli ne Blv Zhan D’Ark, Pallati “Gora” Kulla 3, Njesia Bashkiake 5, Tiranë, Shqipëri.
2. Shitësi, në përbushje të së drejtës për të shitur kuotat e shoqërisë, ka vendosur shitjen e kuotave tek Blerësi, dhe Blerësi, në përpjekje me kushtet e kësaj kontrate fiton pronësinë mbi Kuotat e blera të lira nga çdo barrë.



2



Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nenin 13 të Statutit të Shoqërisë palët bien dakord si më poshtë vijon:

1. Shitblerja e Kuotave

- 1.1. Sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate, në Datën e Firmosjes, Shitësi do t'i shes Blerësit dhe Blerësi do të përfitojë nga Shitësi **10% (dhjete perqind)** të kuotave të shoqërisë "JOMART" sh.p.k, të cilat janë në pronësi të Shitësit, me vlerë prej **10,000 (dhjetë mijë) Lek** "Kuotat që shiten" dhe çdo të drejtë që lidhet me to, të lira nga çdo Barrë, me Vlerën e dakordesuar dhe të pagueshme sipas mënyrës që përcaktohet po aty.
- 1.2. Në Datën e Mbylljes, pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë JOMART sh.p.k do të jetë si më poshtë:

| <i>Ortaku</i> | <i>Kuota</i> | <i>Përqindja e zotëruar në kapitalin</i> | <i>Vlera nominale ne LEK</i> |
|-----------------------------|--------------|--|------------------------------|
| 1. Endri Gjokrushi | 1 | 45% | 45,000 |
| 2. MC Investment Group SHPK | 1 | 10% | 10,000 |
| 3. Endri Gjata | 1 | 45% | 45,000 |

2. VLERA E KUOTAVE DHE MËNYRA E PAGESËS

- 2.1. Vlera totale e Kuotave që shiten është **10,000 (dhjetë mijë) Lek**, ("Vlera e Kuotave") dhe konsiderohet e shlyer në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate ku blerësi është i detyruar të shlyej detyrimin e tij.

3. DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

- 3.1.** Shitësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me Shoqërinë si dhe me Transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijojnë që nga Firmosja e saj. Shitësi, gjithashtu, garanton se përsa është në dijeni aktualisht, çdo deklarim dhe garanci do të jetë e vërtetë, e saktë dhe jo e keqpërdorur në Datën e Firmosjes.
- 3.2.** **ORGANIZIMI.** Shoqëria është krijuar dhe themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në gjendje paaftësie paguese apo në falimentim, dhe ka fuqi të plotë dhe kompetenca për të kryer aktivitetin e saj siç i kryen aktualisht.
- 3.3.** **AUTORIZIMI.** Të gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar që duhet të ndërrmerren nga ose për llogari të Shitësit dhe që autorizojnë Shitësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.
- 3.4.** **PRONËSIA.** Shitësi është pronari dhe mbajtesi i vetëm dhe i ligjshëm i kuotave që shiten dhe që përbëjnë 10% të Kapitalit të Shoqërisë Jomart shpk.
- 3.5.** Kuotat që shiten janë të lira dhe të çliruara nga çdo Barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar Kuotat që shiten në përputhje me afatet e kësaj Kontrate.
- 3.6.** Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barrë në lidhje me Kuotat që shiten ose ndonjë numër kuotash të autorizuara por të paemetuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë drejtë mbi ndonjë Barrë lidhur me ndonjë nga Kuotat që shiten.

4. PREMTIME TË PËRBASHKËTA TË PALËVE

- 4.1.** Palët heqin dorë nga çdo veprim dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për çdo zhvillim, i cili mund të rrezikojë apo të vonojë përfundimin e transaksionit.

- 4.2. Palët, do t'i sigurojnë njëra-tjetrës çdo dhe të gjithë informacionin e nevojshëm përfundimin e këtij Transaksioni.
- 4.3. Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të përbushin kushtet paraprake të parashikuara në këtë kontratë.
- 4.4. Blerësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet brenda kompetencave të tij, që janë të nevojshme përfundimin e kushtet paraprake të parashikuara në këtë kontratë.

5. FORCA MADHORE

- 5.1. Mospërmbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate prej njëres nga Palët, nuk do të quhet shkelje ose mospërmbushje e kësaj Kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një Force Madhore, me kusht që Pala e prekur nga kjo ngjarje (a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, përfundimin e kushtet e kësaj Kontrate, dhe (b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt e mundur përfundimin e këtë ngjarje.
- 5.2. Çdo periudhë brenda së cilës, njëra nga Palët sipas kësaj Kontrate, duhet të kryejë një veprim ose detyrë, do të zgjatet përfundimin e kësaj Kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një Force Madhore, me kusht që Pala e prekur nga kjo ngjarje (a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, përfundimin e kushtet e kësaj Kontrate, dhe (b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt e mundur përfundimin e këtë ngjarje.

6. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

- 6.1. Kjo Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar.
- 6.2. Te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim, në rast se këtë kompetente përfundimin e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

TË NDRYSHME

- 6.3. **NDRYSHIMET.** Çdo korrigjim, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm në qoftë se bëhet më shkrim dhe nënshkruhet nga ose përfundimin e kësaj Kontrate.

6.4. Mos ushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose masë mbrojtëse, që parashikohen në këtë Kontratë ose nga ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose masa mbrojtëse, ose heqje dorë nga të drejta ose masa të tjera mbrojtëse. Mos ushtrimi i vetëm ose i pjesshëm, i një të drejte ose masë mbrojtëse, që parashikohen në këtë Kontratë ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose masës mbrojtëse ose ushtrimin e një të drejte ose mase tjetër mbrojtëse.

6.5. VLEFSHMËRIA E PAVARUR NGA NJËRA TJETRA E DISPOZITAVE KONTRAKTORE. Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridikcion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridikcion tjetër, nuk do të preket ose cenohet nga një fakt i tillë. Palët pranojnë se do të përpilen të zëvendësojnë një dispozitë të pavlefshme ose të pazbatueshme në masën më të madhe të mundshme, për të përm bushur qëllimin e kësaj dispozite.

6.6. NJOFTIMET. Njoftimet ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë Kontratë (“Njoftimi”) do të jenë:

6.6.1. me shkrim;

6.6.2. në gjuhën shqipe;

6.6.3. do dorëzohen ose dërgohen me postë rekomande me kthim per gjigje ose faks, Palës që duhet të marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo Palë.

6.6.4. Me përjashtim të rastit kur provohet se njoftimi është marrë më shpejt, njoftimi do quhet i dhënë nëse:


6.6.4.1. është dërguar me postë, 10 (dhjetë) Dité Pune, pas postimit të tij; dhe

6.6.4.2. është dërguar me faks, kur konfirmimi i dërgimit të tij është regjistruar nga faksi i dërguesit.

- 6.7.** **KALIMI I TË DREJTAVE.** Kjo Kontratë është detyrim ligjor dhe në përfitim të Palëve, trashëgimtarëve të tyre dhe personave të cilëve u kalojnë këto të drejta.
- 6.8.** **KOSTOT DHE TAKSAT.** Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, secila Palë do të paguajë shpenzimet e saj në lidhje me negocimin, hartimin, nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate dhe të shtojcave të saj.
- 6.9.** **TËRËSIA E KONTRATËS.** Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis Palëve që lidhet me objektin e kësaj Kontrate.

* * * * *

Për Shitësin


Endri Gjokrushi

Për Blerësin


Z. Eduard Hyseni
MC Investment Group SHPK
perfaqesuar nga
MC Investment Group
SHPK NIP#141909013 F
TIRANE - ALBANIA

Tiranë më 01.03.2023